

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Isa Kelmendi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit T. P., nga ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson I. S., avokat nga ..., kundër të paditurës KEDS – Korporata Energjetike e Kosovës, Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari L. S., për kompensim dëmi, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3401/16 datë 12.3.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më 12.6.2019, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3401/16 datë 12.3.2019.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3401/16 datë 12.3.2019 është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore, Gjakovë, C.nr.502/2015 datë 6.7.2016, me të cilin është miratuar kërkesëpadia e paditësit dhe është detyruar e paditura që në emër të kompensimit të dëmit material paditësit t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 8.097 €, me kamatë përkatëse ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedhë nga data 9.12.2015 (paraqitja e padisë) e tutje e deri në pagimin definitiv si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 505,40 €, të gjitha në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar dhe ai i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohen ashtu që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pabazuar.

Paditësi ka paraqitur përgjigje në revizionin e të paditurës, me propozim që revizioni të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi aktgjykimin e kundërshtuar konform nenit 215 të LPK-së, dhe gjeti se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi është pronar i shtëpisë në fshatin ..., në të cilën më datë 6.6.2015, rreth orës 5,20 min. është shkaktuar zjarr, ashtu që shkëndijat e liruara nga njehsori dhe pikat e izolimit të shkrirë dhe të shndërruar në flakë nga ormani kryesor shpërndarës, kanë rënë poshtë në dyshemenë e ballkonit në inventarin e shtëpisë duke shkaktuar flakë, me ç'rast është dëmtuar pjesa e përparme e shtëpisë duke filluar nga ballkoni në përdhese deri në pullazin e shtëpisë, ndërsa nga tymi është dëmtuar brendia e shtëpisë dhe inventari.

Në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ngase shkaktar i paraqitjes së zjarrit ka qenë rryma elektrike në njehsorin elektrik elektronik – digjital si pasojë e elementeve elektronike brenda njehsorit, me ç'rast nga djegëja e shtëpisë paditësi ka pësuar dëme në shumën prej 8.097,10 €, dhe pastaj ka obliguar të paditurën më afër përshkruar si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët, drejt i kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Në aktgjykimet e cekura ato kanë dhënë arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Thëniet e revizionit se aktgjykimin i kundërshtuar është marrë në bazë të shkeljes esenciale nga neni 182 par. 2 pika (n) të LPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi si të pabazuar, ngase dispozitivi i aktgjykimin të kundërshtuar është i qartë, nuk është në kundërshtim me arsyetimin dhe përmban arsye të mjaftueshme për gjykim të drejtë e të ligjshëm. Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimin e kundërshtuar e shqyrton konform dispozitës ligjore nga neni 215 të LPK -ës, ndërsa nuk gjeti shkelje të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë

kujdeset sipas detyrës zyrtare. Paditësi në revizion nuk ka cekur asnjë pretendim konkret se ku qëndrojnë shkeljet e pretenduara.

Pretendimet e cekura në revizion se gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të gabuar kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi si të pabazuar, ngase gjykata e shkallës së parë në bazë të ekspertizës së ekspertit të elektroteknikës ka vërtetuar se shkaktar i paraqitjes së zjarrit ka qenë rryma elektrike në njehsorin elektrik elektronik – digjital i cili për arsye të variacioneve të tensionit janë reflektuar në njehsor, me ç’rast është djegur njehsori, i përcjellë me shpërthim, që vjen si pasojë e elementeve elektronike brenda njehsorit, ndërsa lartësinë e dëmit gjykata e ka vërtetuar në bazë të mendimit të ekspertit të ndërtimtarisë i cili ka vlerësuar se dëmi për riparim dhe rindërtim është në vlerën prej 8.097,10 €. Gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitën e nenit 136 dhe nenit 154 të LMD-së sepse e paditura me asnjë provë nuk ka mund të argumentoi pafajësinë e saj, ndërsa sipas dispozitës së cekur rrjedh se ai që i shkakton dëm tjetrit ka për detyrim t’ia shpërblejë atë.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi pretendimet e cekura në revizion lidhur me konstatimin e ekspertit të elektroteknikës, papranueshmërinë e raporteve të AMR, pretendimin se nuk është vërtetuar se ditën kritike ka pas luhatje apo variacione të tensionit, por të njëjtat kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike për të cilën konform nenit 214 par. 2 të LPK –ës revizioni nuk mund të paraqitet. Përkundër kësaj kjo Gjykatë shton se në seancën kryesore më datë 17.6.2016, eksperti i elektroteknikës është përgjigjur në të gjitha pyetjet e parashtruara të palëve duke vërtetuar se problemi ka qenë te njehsori – pikat e përçuesve në njehsor, të cilin mendim palët nuk e kanë kundërshtuar.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 222 të LPK –ës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.162/2019 datë 12.6.2019

Kryetare e kolegjit,
Emine Kaçiku